



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 22 gusht 2013

Për: Kryetarët e Komunave të Republikës së Kosovës
Kryesuesit e Kuvendeve të Komunave

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar/a,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), duke u bazuar ne mandatin e saj të përcaktuar në shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me qëllim të zhvillimit të legjislacionit për vetëqeverisje efikase komunale, ka obligim ligjor të identifikoj kompetencat e komunave në bazë të ligjeve të nxjerrura nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji Nr.04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr.03/L-221 dhe Nr.04/L-116 është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.28 më 07 gusht 2013.

Ky Ligj ka për qëllim të përcaktoj parimet e politikës fiskale dhe kornizën ligjore për përgatitjen dhe implementimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës, që synon të mbajë borxhin në nivele të qëndrueshme me anë të konsistencës ndërmjet bilanceve buxhetore, niveleve të borxhit dhe rritjes ekonomike afatmesme.

Bashkangjitur me këtë shkresë përcjellëse gjeni:

1. Ligjin Nr.04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr.03/L-221 dhe Nr.04/L-116;
2. Shkresë shpjeguese për përmbajtjen e obligimeve ligjore të autoriteteve lokale.

Me respekt,

Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së

Kopje: Slobodan Petrović, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,
Udhëheqësve të Departamenteve në MAPL
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Pristina, 23 avgust 2013

Za: Gradonačelnike Opština Republike Kosovo
Predsedavajući Skupština Opština

Predmet: Propratni dopis

Poštovani-e,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave (MALS), na osnovu svog mandata odredjenog prema dodatku XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, u cilju razvoja zakonodavstva za efikasnu lokalnu samoupravu, ima zakonsku obavazu da identifikuje nadležnosti opština na osnovu donešenih zakona od Skupštine Republike Kosova. Zakon Br.04/L-194 o izmeni i dopuni Zakona Br.03/L-048 o menadžiranju javnih finansija i odgovornosti, izmenjeno i dopunjeno sa Zakonima Br.03/L-221 i Br.04/L-116 usvojen je u Skupštini Republike Kosovo i dekretiran od Presednice Republike Kosovo, objavljen je u Službenom Glasniku Republike Kosovo Br.28 od 07 avgusta 2013.

Ovaj Zakon ima za cilj da odredi načela fiskalne politike za zakonskim okvirom za pripremanje i primenjivanje Budžeta Republike Kosovo, koji cilja da drži dugove na održivom nivou pomoću odnosa bilansa budžeta, nivoa duga i srednjoročnog ekonomskog rasta.

Uz ovaj dopis ćete naći:

1. Zakon br.04/L-194 za izmenu i dopunu Zakona Br.03/L-048 o menadžiranju javnih finansija i odgovornosti, izmenjeno i dopunjeno sa Zakonima br.03/L-221 i br.04/L-116;
2. Dopisu obješnjenja o zakonskom sadržaju lokalnih autoriteta.

S poštovanjem,

Besnik Osmani,
Generalni Sekretar MALS-a

Kopija: Slobodan Petrović, Zaanikpremijera i Ministar MALS-a,
Rukovodioci Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a.



MAPL – DORACAK I LIGJEVE PËR KOMUNA

LIGJI NR.04/L-194 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCave PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSIT, TË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJET NR.03/L-221 DHE NR.04/L-116

Ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	04/L - 194
Hyrja në fuqi	22.08.2013
Numri i Udhëzuesit në Doracak	A-001/13
Data e Udhëzuesit në Doracak	21 gusht 2013

Ministria Përkatëse	Ministria e Financave
---------------------	-----------------------

Me këtë ligj rregullohen parimet e politikës fiskale dhe kornizën ligjore për përgatitjen dhe implementim të Buxhetit të Republikës së Kosovës, që synon të mbajë borxhin në nivele të qëndrueshme me anë të konsistencës ndërmjet bilanceve buxhetore, niveleve të borxhit dhe rritjes ekonomike afatmesme.

Në kuadër të Ministrisë së Financave themelohen:

- Departamenti i Buxhetit; dhe
- Departamenti i Buxhetit Komunal.

Departamenti i Buxhetit Komunal është i autorizuar dhe përgjegjës për:

- përgatitjen e propozim buxhetit të komunave;
- përgatitjen e pjesës së Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale si pjesë integrale e KASH-it;
- ndihmon në zbatimin e Buxhetit të Komunave të Republikës së Kosovës;
- shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndryshimin e ndarjeve buxhetore; dhe
- ushtrimin e të gjitha përgjegjësiave të tjera të cilat i janë dhënë Departamentit të Buxhetit Komunal me kuadrin ligjor. Ky departament do t'ju siguroj mbështetje Komunave me qëllim që t'iu ndihmojë në përmbushjen e obligimeve të përcaktuara me kuadrin ligjor.

Asnjë Ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të BPV-së së parashikuar. Kufiri i deficitit të çdo komune në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni do të jetë në proporcion me pjesën e saj të shpenzimeve në ligjin e fundit për ndarjet buxhetore.

Për qëllime të pajtueshmërisë me kufirin e deficitit nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk do të merren parasysh shpenzimet e Agjencionit Kosovar të Privatizimit si dhe shpenzimet buxhetore që mund të rezultojnë nga:

- shpenzimi i të hyrave vetanake të nivelit qendror dhe komunal të bartura nga viti paraprak, sipas nenit 27 të ligjit bazik; dhe
- pranimet tjera të të hyrave që janë mbi të hyrat e buxhetuara nga viti paraprak, duke mos cenuar nenin 31.3 të Ligjit për financat e pushtetit lokal, mund të barten në vitin vijues për ndarje të reja buxhetore, por vetëm për shpenzime kapitale.

Pavarsisht nga neni 2. i nenit 12 (22A), të këtij ligji, pjesëmarrja e komunave në kufirin e deficitit mbetet e pa ndryshuar në rast se kufiri i deficitit rritet përkohësisht në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, përveç nëse Kuvendi vendos të rrisë pjesëmarrjen individuale të një apo më tepër komunave deri në masën e plotë të paragrafit 2. të nenit 12(22A), të këtij ligji.

Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave, apo të ndonjë organizate tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me ligj e të cilat barten në vitin vijues.

Neni

I

5.1

i

ii

5.3

i

ii

iii

iv

v

22.A.1

22.A.2

22.A.5

a)

b)

22.B.3

27



MALS – PRIRUČNIK ZAKONA ZA OPŠTINE
ZAKON BR.04/L-194 ZA IZMENU I DOPUNU ZAKONA BR.03/L-048 O
MENADŽIRANJU JAVNIH FINANSIJA I ODGOVORNOSTI, IZMENJENO I
DOPUNJENO SA ZAKONIMA BR.03/L-221 I BR.04/L-116

Zakon usvojen od Skupštine Kosova	04/L - 194
Stupanje na snagu	22.08.2013
Broj Uputstva u Priručniku	A-001/13
Datum Uputstva u Priručniku	21 gusht 2013

Dotično Ministarstvo	Ministarstvo Finansija
-----------------------------	-------------------------------

Sa ovim zakonom se regulišu načela fiskalne politike sa zakonskim okvirom za pripremanje i implementim Budžeta Republike Kosovo, koji cilja da održi dugove na održivom nivou pomoću odnosa između budžetskog bilansa, sa nivoima duga i srednjoročnog ekonomskog rasta.

U sklopu Ministarstva Finansija se osnivaju :

- Uprava Budžeta ; i
- Uprava opštinskog Budžeta.

Uprava opštinskog Budžeta je ovlašćena i odgovorna za :

- Pripremanje predloga budžeta za opštine ;
- Pripremanje dela Srednjoročnog Opštinskog Okvira Budžeta kao integralni deo KASH-;
- Pomaže u sprovođenju Budžeta Opština Republike Kosova;
- Razmatranje i procenjivanje zahteva za promenu budžetskih podela; i
- Vršnju drugih odgovornosti koje su date Upravi Opštinskog Budžeta premas zakonu.Ova Uprava će obezbediti podršku opštinama da im se pomogne u ispunjavanju određenih obaveza prema zakonu.

Nijedan zakon za budžetsku podelu ne treba da obuhvati jedan opšti deficit koji prolazi nivo od 2% predviđenog BPV-Granica deficita svake opštine u skladu sa paragrafom 1.ovog člana će biti u proporciji sa njegovim delom tražokova u zadnjem zakonu za budžesku podelu.

U cilju slaganja sa granicom deficita iz paragrafa 1.ovoga člana,neće se uzeti u obzir troškovi Kosovske Agencije za Privatizaciju kao i budžetski troškovi koji mogu da rezultiraju od:

- Potrošnja sopstvenih prihoda centralnog i opštinskog nivoa prenešene od prethodne godine , prema članu 27 bazičnog zakona; i
- Drugih primanja prihoda koja su iznad budžetiranih prihoda od prethodne godine,ne ugrožavajući član 31.3.Zakona o finansijama lokalne samouprave, mogu se preneti u tekuću godinu za nova budžetske podele,ali samo za kapitalnu potrošnju.

Nezavisno od člana 2. i člana 12 (22A), ovog zakona, učešće opština na granici deficita ostaje nepromenjeno ako je granica deficita privremeno porasla u skladu sa paragrafom 1. ovoga člana, samo ako Skupština odluči da poveća idividualno učešće jedne ili više opština do pune mere paragrafa 2. člana 12(22A), ovoga zakona.

Sve budžetske podele za fiskalnu godinu će isteći u ponoć 31 decembra, osim budžeskih podela koja se nadovezuju sa opštinskim sopstvenim nepotrošenim sredstvima, ili neke druge budžetske organizacije kojoj su zakonom odobrena da se prenose u tekuću godinu.

Član

I

5.1

i

ii

5.3

i

ii

iii

iv

v

22.A.1

22.A.2

22.A.5

a)

b)

22.B.3

27

LIGJI NR. 04/L-194
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCave PUBLIKE
DHE PËRGJEGJËSITË, TË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJET NR. 03/L-221 DHE NR. 04/L-116

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCave
PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, TË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJET NR. 03/L-221 DHE LIGJIN
NR. 04/L-116

Neni 1

1. Termi **"ligji bazik"** i përdorur në dispozitat e këtij ligji përfshin Ligjin Nr. 03/L-048 të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 03/L-221 dhe Nr. 04/L-116.
2. Në tërë tekstin e ligjit bazik **"Ministria e Ekonomisë dhe Financave"** zëvendësohet me **"Ministria e Financave"**.
3. Në tërë tekstin e ligjit bazik **"Fondi i Konsoliduar i Kosovës (FKK)"** zëvendësohet me **"Fondi i Konsoliduar i Republikës së Kosovës (FKRK)"**.
4. Në tërë tekstin e ligjit bazik **"Departamenti i Thesarit"** zëvendësohet me **"Thesari"**.
5. Në tërë tekstin e ligjit bazik termi **"Rregullat e KMF"** zëvendësohet me termin **"aktet nënligjore"**.

Neni 2

1. Në nenin 1 të ligjit bazik ndryshohen dhe riformulohen përkufizimet si në vazhdim:

1.1. Përkufizimi **"Auditor i Përgjithshëm"** riformulohet si në vijim:

"Auditori i Përgjithshëm i Kosovës" ka kuptimin e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës.

1.2. Përkufizimi **"Ministria"** riformulohet si në vijim:

"Ministria" nënkupton Ministrinë e Financave.

1.3. Përkufizimi **"Ministri"** riformulohet si në vijim:

"Ministri" nënkupton Ministrin e Ministrisë së Financave.

1.4. Përkufizimi **"Rregullat e KMF"** riformulohet si në vijim:

"Menaxhimi Financiar dhe Kontrollit (MFK)" është një sistem gjithëpërfshirës i politikave, procedurave, aktiviteteve dhe përgjegjësi për të menaxhuar dhe kontrolluar shfrytëzimin e fondeve publike, ku përfshihen të hyrat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet, bazuar në menaxhimin e rrezikut, me qëllim të ofrimit të sigurisë, që objektivat e institucionit do të arrihen në mënyrë ligjore, ekonomike, efikase dhe efektive.

1.5. Në përkufizimin **"Zyrtar financiar"** fshihet fjala **"Auditorin e Brendshëm"**.

2. Në nenin 1 të ligjit bazik, paragrafi 1.1, shtohen këto përkufizime të reja:

"BPV" nënkupton vlerën totale të mallrave finale dhe të shërbimeve të prodhuara brenda Kosovës gjatë një viti fiskal, të matur nga Agjencia Statistikore e Kosovës, e themeluar me Ligjin nNr. 04/L-36 për Statistikat Zyrtare të Republikës

së Kosovës.

"BPV i parashikuar" nënkupton BPV-në e përfshirë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

"Kufiri i deficitit" nënkupton kufirin e definuar në nenin 12 (22A) të këtij ligji.

"Tejkalim i deficitit" nënkupton një devijim nga kufiri i deficitit që kalon 0.5% të BPV-së së parashikuar në një vit të vetëm fiskal apo në mënyrë kumulative gjatë dy (2) viteve pasuese fiskale.

"KASH" do të thotë Korniza Afatmesme e Shpenzimeve në përputhje me nenin 19.1. të ligjit bazik.

"Deficiti i përgjithshëm" nënkupton deficitin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për këtë vit, pa përfshirë shpenzimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

"Borxhi total" nënkupton tërë borxhin shtetëror dhe komunal, të definuar në Ligjin Nr. 03/L-175 për Borxhin Publik.

"Të hyrat vetanake të organizatave buxhetore qendrore" nënkupton çdo lloj të parasë publike që është vlerësuar në bazën e mbulimit të kostos dhe që është mbledhur në formë të tarifave dhe ngarkesave nga ana e organizatave buxhetore qendrore. Megjithatë, nga ky definicion përjashtohen në mënyrë specifike të hyrat e dedikuara për agjencitë e pavarura.

"Të hyrat vetanake komunale" do të thotë të gjithë të hyrat e parasë publike që janë vlerësuar dhe që janë mbledhur nga një komunë nga ndonjë burim i specifikuar në nenin 8 të Ligjit nNr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.

"Shpenzimet rrjedhëse" do të thotë pagesat e kryera përveç se për asetet kapitale apo për mallrat ose shërbimet që do të përdoren në prodhimin e aseteve kapitale, dhe pagesat e pakthyera për qëllime të tjera përveç se t'u lejohet pranuesve blerja e aseteve kapitale, për kompensim të marrësit për dëmtim apo shkatërrim të aseteve kapitale, apo për rritje të kapitalit financiar të marrësit.

"Shpenzimet kapitale" do të thotë pagesat për blerje të aseteve kapitale fikse, stoqeve strategjike apo emergjente, të tokës apo aseteve të paprekshme, apo pagesat e pakthyera që i lejojnë marrësit blerjen e atyre aseteve, për kompensim të marrësit për dëmtim apo shkatërrim të aseteve kapitale, apo për rritje të kapitalit financiar të marrësit.

"Të ardhurat nga privatizimi" nënkupton të gjitha të ardhurat që mund të vijnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës si rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve në pronësi publike dhe/apo të ardhurat nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, duke mos përfshirë të hyrat e dedikuara të AKP-së.

"Bilancet bankare" nënkupton shumën e të gjitha parave që mbahen si pjesë e Llogarisë së vetme të Thesarit, në çdo moment kohor, përfshirë këtu rezervat për asistencën emergjente për likuiditet sipas paragrafit 5. të nenit 18 të ligjit bazik.

"Klasë Investuese" nënkupton vlerësimin nga një agjenci vlerësuese e njohur ndërkombëtarisht (Standard and Poor's, Moody's, Fitch) që dëshmon se instrumenti i borxhit që mban këtë klasifikim, ka rrezik relativisht të vogël të mos-pagesës. Qeveritë ose Institucionet tjera, instrumentet e të cilave klasifikohen si klasë investuese, konsiderohen që kanë kapacitete financiare të mjaftueshme për t'i përmbushur obligimet për pagesën e instrumenteve të borxhit në kohë dhe tërësi.

"Institucion Mbikombëtar Financiar" nënkupton institucione mbikombëtar financiar formohet nga dy ose më shumë shtete sovraane me qëllim të promovimit të zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së stabilitetit financiar për vendet anëtare.

"Borxhi Shtetëror" nënkupton borxhin që merret në emër të Institucioneve Qendrore Qeveritare të cilin Republika e Kosovës është e obliguar ta paguajë, por nuk përfshinë asnjë detyrim të entiteteve të tjera të caktuara qeveritare, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në komuna, ndërmarrje publike apo në BQK.

"Letrat me Vlerë" nënkupton instrumente të Borxhit Shtetëror të emetuara me bazë të interes-bartjes, me bazë zbritjeje, apo të indeksuara dhe sipas afateve dhe kushteve që mund t'i përcaktojë Ministri i Financave.

Neni 3

Pas nenit 1 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 1A me tekstin në vazhdim:

Neni 1A Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është:

1.1. të përcaktojë parimet e politikës fiskale dhe kornizën ligjore për përgatitje dhe implementim të Buxhetit të Republikës së Kosovës, që synon të mbajë borxhin në nivele të qëndrueshme me anë të konsistencës ndërmjet bilanceve buxhetore, niveleve të borxhit, dhe rritjes ekonomike afatmesme; dhe

1.2. t'i akordojë Ministrit autoritetin dhe përgjegjësinë për përgatitje dhe implementim të Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe të amendamenteve të tij, për të shmangur apo kompensuar një deficit të tepruar apo për të rivendosur kufirin e deficitit.

Neni 4

Në nenin 4 të ligjit bazik, në paragrafin 4.9., në rreshtin e tretë dhe të pestë, fshihet fjalia "si dhe zbatimin e Rregullave KMF".

Neni 5

1. Titulli i nenit 5 të ligjit bazik "Departamenti i Buxhetit" zëvendësohet me titullin "Departamentet e Buxhetit".

2. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 5.1. riformulohet si vijon:

5.1. Në kuadër të Ministrisë së Financave themelohen: i) Departamenti i Buxhetit dhe ii) Departamenti i Buxhetit Komunal.

3. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 5.2 togfjalëshi "Përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Ministri, njësia e buxhetit qendror pranë Departamentit të Buxhetit është e autorizuar" zëvendësohet me togfjalëshin "Departamenti i Buxhetit është i autorizuar".

4. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 5.2, pas pikës (iv) shtohet një pikë e re me tekstin si vijon:

(v) vlerësimin e ndikimit financiar të politikave qeveritare.

5. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 5.2, pika (v) rinumërohet si (vi).

6. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 5.3, riformulohet si në vazhdim:

5.3. Departamenti i Buxhetit Komunal është i autorizuar dhe përgjegjës për (i) përgatitjen e Propozim Buxhetit të Komunave, (ii) përgatitjen e pjesësëspjesëzës së Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale si pjesë integrale e KASH-it, (iii) ndihmë në zbatimin e Buxhetit të Komunave të Republikës së Kosovës, (iv) shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndryshimin e ndarjeve buxhetore dhe (v) ushtrimin e të gjitha përgjegjësiave të tjera të cilat i janë dhënë Departamentit të Buxhetit Komunal me kuadrin ligjor. Ky departament do t'ju siguroj mbështetje Komunave me qëllim që tu ndihmojë në përmbushjen e obligimeve të përcaktuara me kuadrin ligjor.

Neni 6

1. Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 6.2. riformulohet si në vijim:

6.2 Njësia Qendrore Harmonizuese (NjQH) themelohet në Ministrinë e Financave si njësi, që drejtpërsëdrejti i raporton Ministrit të Financave. NjQH do të përbëhet nga dy njësi: Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, përgjegjësitë e të cilës do të përkufizohen në pajtim me Ligjin për Auditimin e Brendshëm; dhe Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll, e cila do të:

a) hartoj dokumentet strategjike dhe udhëzimet në fushën e MFK-së, në pajtueshmëri me standardet e

- pranuara ndërkombëtare, praktikat dhe rregulloret në Bashkimin Evropian;
- b) hartoj legjislacionin sekondar që lidhet me MFK-në, të cilin e nënshkruan Ministri i Financave;
 - c) hartoj politikat për zhvillimin, përmirësimin dhe monitorimin e MFK-së;
 - d) përcaktoj përmbajtjen e programeve të trajnimit dhe të koordinoj programet e trajnimit në fushën e MFK-së;
 - e) vlerësoj përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të MFK-së në organizatat buxhetore;
 - f) përshkruaj formën e raportit vjetor, procedurat dhe afatet e fundit për raportim për MFK;
 - g) monitoron zbatimin e rregulloreve në fushën e MFK-së, bazuar në raportet vjetore të pranuar nga organizatat buxhetore;
 - h) përgatis raportet e konsoliduara vjetore për MFK-në dhe të i dorëzoj ato te Ministri i Financave;
 - i) koordinon dhe përkrah trajnimin profesional në fushën e MFK-së në organizatat buxhetore.

2. Neni 6 i ligjit bazik, paragrafët, 6.3. 6.4, 6.5 dhe 6.6, fshihen nga teksti i ligjit.

Neni 7

1. Neni 9 i ligjit bazik paragrafi 1. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

9.1. Fondet nga Fondi i Konsoliduar i Republikës së Kosovës mund të investohen vetëm në një ose më shumë Investime të Autorizuara, të cilat duhet të përbëhen ekskluzivisht nga këto në vijim:

- a) një llogari rrjedhëse që paguan interes në BQK;
- b) një depozitë të afatizuar në BQK;
- c) një fond të tregut të parave nëse:
 - i. fondi u nënshtrohet rregullave dhe rregulloreve të Komisionit për Letra me Vlerë dhe Këmbime të SHBA-së ose të një Institucioni Mbikëqyrës të BE-së, dhe
 - ii. portofoli i atij fondi përbëhet vetëm nga letra me vlerë të klasifikuara si Klasë Investuese;
- d) një bono ose një instrument tjetër borxhi i cili është lëshuar ose është garantuar nga Shtetet e Bashkuara ose një shtet anëtar i BE-së dhe i cili është klasifikuar si Klasë Investuese nga një agjenci e mirënjohur ndërkombëtare e klasifikimit;
- e) një depozitë në cilëndo bankë komerciale në Kosovë e cila është e siguruar me sigurimin e depozitave të BQK nëse;
 - i. kjo bankë është klasifikuar si Klasë Investuese ose
 - ii. shumica e aksionarëve të saj janë klasifikuar si Klasë Investuese nga një agjenci e mirënjohur ndërkombëtare e klasifikimit;
- f) një depozitë në cilëndo bankë të huaj e cila është e organizuar në përputhje me ligjet e një shteti anëtar të BE-së dhe e cila është klasifikuar si Klasë Investuese nga një agjenci e mirënjohur ndërkombëtare e klasifikimit;
- g) një marrëveshje të ri-blerjes në bazë të së cilës letrat e blera me vlerë përbëhen vetëm nga bono ose letra të tjera me vlerë të përcaktuara në pikën (f) më sipër dhe të cilat mbahen nga një palë e tretë kujdestare;
- h) një bono ose instrument tjetër borxhi lëshuar nga institucione mbikombëtare financiare me kusht

që instrumentet e tilla të jenë të klasifikuara si Klasë Investuese nga një agjenci e mirënjohur ndërkombëtare e klasifikimit.

Neni 8

Në nenin 11 të ligjit bazik, paragrafi 11.5, fshihet në tërësi.

Neni 9

Neni 14 i ligjit bazik paragrafi 7. riformulohet si në vazhdim:

14.7. Nëse gjatë funksionimit të mbikqyrjesmbikqyrjes menaxheriale, kontroleve të brendshme, auditimit të brendshëm dhe/ ose auditimit të jashtëm konstatohet se ka pasur dështim sistematik për kryerjen e detyrës nga Zyrtari Kryesor Financiar ose Zyrtari Certifikues, Zyrtari Kryesor Administrativ merr masa disiplinoredisciplinore deri te shkarkimi i personit në fjalë nga pozita përkatëse. Zyrtarët Financiar të shkarkuar në këtë mënyrë, nuk mund të emërohen si Zyrtarë Financiar në asnjë Organizatë Buxhetore.

Neni 10

1. Neni 20 i ligjit bazik, në paragrafin 20.2, në pikën "(ii)," pas togfjalëshit "**për komunën**" shtohet togfjalëshi "**pjesën e saj në kufirin e deficitit**".

2. Neni 20 i ligjit bazik, në paragrafin 20.4, pika (iii), pas togfjalëshit "**në rastin e komunës**", shtohet togfjalëshi "**pjesën e saj në kufirin e deficitit dhe**".

Neni 11

Në nenin 21 të ligjit bazik, paragrafi 21.1, pika "a" zëvendësohet me tekstin si në vijim:

a) një mbishikim të rrethanave ekonomike në të cilat është përgatitur buxheti dhe rekomandimet për një strategji afat-shkurte dhe afat-mesme fiskale, e cila, nëse kërkohet, përfshin përshtatjet fiskale për të adresuar çështjet e parapara në pikën i dhe ii, të këtij paragrafi. Përshtatjet e tilla fiskale duhet të realizohen në një horizont më të shkurtër kohor në rast të rritjes së të hyrave. Në veçanti, cilat do pranime të të hyrave që janë mbi të hyrat e buxhetuara përdoren në tërësi për të kompensuar deficitet e tepruara dhe për të rivendosur kufirin e deficitit:

i. për të kompensuar brenda tri (3) viteve fiskale një deficit të tepruar, apo

ii. për të rivendosur kufirin e deficitit pas një rritjeje të tij në përputhje me nenin 12 (22B) të këtij ligji, qoftë brenda tri (3) viteve fiskale nëse deficit i tepruar ka qenë më i vogël se 1% apo brenda pesë (5) viteve fiskale në rast të një deficit të tepruar më të lartë.

Neni 12

Pas nenit 22 të ligjit bazik, shtohen nenet e reja 22A dhe 22B:

Neni 22A

Vendosja dhe përshtatja e kufirit të deficitit

22.A.1. Asnjë Ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të BPV-së së parashikuar.

22.A.2. Kufiri i deficitit të çdo komune në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni do të jetë në proporcion me pjesën e saj të shpenzimeve në ligjin e fundit për ndarjet buxhetore.

22.A.3. Me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

a) kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së të parashikuar në KASH-in më të fundit, dhe

b) procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

22.A.4. Kufiri i deficitit mund të përshtatet edhe më herët nëse në një përshtatje të tillë synon stabilizimin e nivelit të parashikuar total të borxhit në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit në rastet e parapara në vazhdim:

- a) një tejkalim i deficitit nuk është kompensuar brenda tri (3) viteve fiskale; apo
- b) kufiri i deficitit është rritur në përputhje me nenin 12(22B) të këtij ligji për dy (2) vite fiskale, brenda tri (3) viteve fiskale pasuese;

22.A.5. Për qëllime të pajtueshmërisë me kufirin e deficitit nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk do të merren parasysht shpenzimet e Agjencionit Kosovar të Privatizimit si dhe shpenzimet buxhetore që mund të rezultojnë nga:

- a) shpenzimi i të hyrave vetanake të nivelit qendror dhe komunal të bartura nga vitit paraprak, sipas nenit 27 të ligjit bazik;
- b) pjesa e pashpenzuar e ndarjeve buxhetore nga vitit paraprak, mund të përdoren si burim i financimit të ndarjeve të reja buxhetore, në kategorinë e shpenzimeve kapitale; dhe
- c) pranimet tjera të të hyrave që janë mbi të hyrat e buxhetuara nga viti paraprak, duke mos cenuar nenin 31.3. të Ligjit për financat e pushtetit lokal, mund të barten në vitin vijues për ndarje të reja buxhetore, por vetëm për shpenzime kapitale.

22.A.6. Të ardhurat nga privatizimi dhe shpenzimi i tyre nuk do të merren parasysht për qëllimet e respektimit të kufirit të deficitit. Këto të ardhura mund të përdoren vetëm për projekte që janë përfshirë në programin kapital ashtu si përcaktohet në nenin 21 të ligjit bazik, nëse niveli i bilancit të përdorshëm bankar të qeverisë arrin në të paktën 4.5% të BPV-së së parashikuar.

Neni 22B **Rritja e përkohshme e kufirit të deficitit**

22.B.1. Kuvendi mundet të rrisë kufirin e deficitit nëse shfaqet ndonjë ngjarje apo kombinim i ngjarjeve, duke përfshirë rastin kur pasojat e specifikuara financiare dhe ekonomike parashikohet të kenë ndikim të madh në buxhetin e përgjithshëm në vitin fiskal kur shfaqen ato ngjarje apo në vitin fiskal pasues:

- a) për cilëndo periudhë prej gjashtë (6) muajve brenda një viti fiskal, mbledhja nominale e të hyrave tatimore është e barabartë apo më e ulët se të hyrat tatimore të mbledhura gjatë periudhës së njëjtë të vitit fiskal paraprak, pa përfshirë efektin e politikave dhe të hyrat e njëhershme tatimore; apo
- b) në rast të gjendjes së jashtëzakonshme brenda kuptimit të nenit 131.1. të Kushtetutës, përfshirë këtu ndonjë katastrofë natyrore; apo
- c) në rast të ndonjë krize në sistemin bankar të identifikuar bashkërisht nga Ministri dhe Guvernatori i BQK-së, me propozim të BQK-së; apo
- d) një garancie shtetërore brenda kuptimit të Ligjit Nr. 03/L-175 për borxhin publik, që do të duhet të paguhet nga Qeveria dhe që ka ndikim në shpenzimet totale mbi 1.5% të BPV-së së parashikuar.

22.B.2. Rritja e kufirit të deficitit në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni nuk duhet të tejkalojë ndikimin fiskal të ngjarjeve relevante dhe periudhën e ndikimeve fiskale të këtyre ngjarjeve. Në çdo rast, kufiri i deficitit nuk do të ngritet ngjitur për një periudhë që tejkalon pesë (5) vite fiskale të njëpasnjëshme.

